




|                                                                                     |                                          |
|-------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO                             |                                          |
| AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |                                          |
| Dep.<br>Dep. <u>2-D/DPC</u>                                                         | Nr. Prot.<br>Br. Prot. <u>01-2911/12</u> |
| Nr. I faq.<br>Broj stranica <u>02</u>                                               | Data<br>Datum <u>16-08-2012</u>          |
| Nr. pages                                                                           | PRISTINE                                 |



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **09.08.2012**, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbyllen rastet me Nr. AKK-03-4779-11, AKK-03-4781-11, AKK-03-4780-11, dhe AKK-03-4782-11, për z. Astrit Hyseni – ish Drejtor i Programit në Universitetin e Prizrenit, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky ish Zyrtar i lartë publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rastet e hapura nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-4779-11, AKK-03-4781-11, AKK-03-4780-11, dhe AKK-03-4782-11, për Zyrtarin e lartë, z. Astrit Hyseni – tani ish Drejtor i Programit të Soft.Designe and TIT në Universitetin e Prizrenit, janë trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Pas identifikimit të rasteve (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksione menaxhues në disa biznese private, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit konsiderohet papajtueshmëri funksionesh, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Zyrtarit të lartë, z. Astrit Hyseni i është bërë shkresa e parë njoftuese, pas të ciles z.Hyseni është paraqitur në Agjencinë kundër Korrupsionit dhe në takim me zyrtarët e Agjencinë është njoftuar për situatën në të cilën ndodhet. Z.Hyseni në këtë takim ka njoftuar se ai tashmë nuk është më në

funkcionin e personit zyrtar dhe për ta argumentuar këtë do të sjell kontratën e punës e cila është e shkëputur vetëm pas një viti akademik në këtë funksion.

Me datën 03.08.2012, kemi marr dokumentin "Kontratë pune" të z.Astrit Hyseni (DPK/DPKI, 03-2729/12) të lëshuar nga Universiteti i Prizrenit në të cilën, pos tjerash, shkruan se funksioni i tij publik si Drejtor i Programit të Soft.Designe and TIT në këtë Universitet ka përfunduar me datën 01.10.2011.

Edhe pse kontrata shkruan gjithashtu se ajo ka mundësi vazhdimi deri me 2015, z.Hyseni ka deklaruar se ajo më nuk është vazhduar dhe ka përfunduar me datën e përmendur më heret.

Në bazë të këtyre dokumenteve zyrtare, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin publik (Ligji Nr.04/L-051), kemi konstatuar se, mos ushtrimi i funksionit publik nga ish zyrtari i lartë Astrit Hyseni, dëshmon se tashmë është shmangur situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

